



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembl*

---

**Legjislatura IV**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 18  
Prishtinë, më 22.08.2012, në orën 11.00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Duda Balje dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Justina Pula dhe Biserka Kostiq.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinatore dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

I ftuar: Sami Kurteshi -Avokat i Popullit.

Pjesëmarrës të tjerë: Shqipe Ibraj, Irfan Kastrati- drejtor ekzekutiv, Isa Hasani, Merxhan Avdyli nga IAP; Lejla Selimi dhe Nehat Dervishi OSBE; Nevahir Hazeri-KDI, Visar Bivolaku-EU OFFICE-EUSR; Nuredin Ibishi- CDF, Burim Tahiri dhe Florije Kryeziu-UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Ftohet Avokati i Popullit që para Komisionit të prezantojë Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011;
3. Të ndryshme.

**Kryetarja** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Ftohet Avokati i Popullit që para Komisionit të prezantojë Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011**

**Kryetarja**- Njoftoi anëtarët e Komisionit se në këtë mbledhje do te shqyrtohet Raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011. Ajo e ftoi Avokatin e Popullit që të prezantojë raportin para anëtarëve të Komisionit.

**Z. Sami Kurteshi, Avokat i Popullit** – E falënderoi Komisionin për mundësinë që i është dhënë për paraqitjen e këtij raporti. Ai i kërkoi falje Komisionit që raporti është paraqitur me vonesë dhe tha: “Raporti është botuar në të gjitha gjuhët, ashtu siç është e paraparë dhe është harmonizuar me standardet gjuhësore”.

Ai më tutje tha: “Gjatë vitit 2011 kemi pasur një rritje të ankesave për 10-12%, ndërsa vlen të theksohet se është rritur edhe përqindja e rasteve të këtyre ankesave, që Institucioni i Avokatit të Popullit i ka zgjidhur pozitivisht, prandaj është shqetësues se numri më i madh i ankesave u dedikohet gjykatave të të gjitha niveleve”.

Ai tha se ky institucion po ballafaqohet me probleme të shumta, sepse po degradohemi si nga individët, ashtu edhe nga operatorët ekonomikë. Në vijim, ai tha se një gjendje jo e mirë nuk qëndron lidhur me lirinë e lëvizjes në territorin e Kosovës, gjë që nuk është e njëjtë.

Prandaj, edhe pse ballafaqohet me vështirësi, prapë nuk do të ndalet së punuari për të mirën e qytetarit dhe për të mirën e Republikës së Kosovës.

Kërkesë e tij ishte që Komisioni t’i drejtohet Kuvendit të Kosovës për t’ia mundësuar Avokatit të Popullit, që të jetë prezent në seancë plenare gjatë shqyrtimit të raportit dhe t’i mundësohet që t’u përgjigjet pyetjeve të parashtruara nga ana e deputetëve lidhur me raportin.

**Kryetarja** – E falënderoi për prezantimin e Raportit vjetor dhe ftoi anëtarët e Komisionit që të bëjnë pyetje, të cilave ai do t’u përgjigjet dhe do të japë sqarimet e duhura.

**Kymete Bajraktari** – Raportin e vlerësoi si real, por kërkoi sqarim rreth faqes 104 ku flitet për gjyqësorin, ndërsa e vlerëson si të pakuptimtë që palës t’i lihet në kompetencë se a i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut, duhet konstatuar faktet dhe të nxirret rekomandimi që të udhëzohet pala se si të veprojë.

Ajo gjithashtu bëri vërejtje për raportin në fjale, sepse i mungojnë të drejtat e fëmijëve, pastaj trafikimi me fëmijë, si dhe pasqyra financiare e Institucionit të Avokatit të Popullit nuk është prezantuar në mënyrë reale, edhe pse raporti përshkruan disa shpenzime, si të telefonisë mobile etj.

**Pyetjes së deputetes iu përgjigj z. Sami Kurteshi, ndaj së cilës deputetja nuk pati vërejtje.**

**Rita Hajzeraj** – Kërkoj nga Avokati i Popullit të sqarojë rreth rekomandimeve që u bëhet ministrive dhe institucioneve publike, lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe pyeti: Pse ka vonesë në hartimin e Projektligjit për pensionet, mungesa e vakumit të Ligjit për sigurime shëndetësore dhe pse deri më tani Avokati i Popullit nuk ka kërkuar nga këto ministri për hartimin e këtyre projektligjeve? Sipas saj, rekomandimet e tilla nuk qëndrojnë në raport.

**Sami Kurteshi, Avokat i Popullit** – E pranoi vërejtjen e deputetes dhe e vlerësoi si të qëlluar. Në të ardhmen, Avokati i Popullit do të dalë me rekomandime të veçanta, të cilat do t'u adresohen ministrive përkatëse.

**Duda Balje** – Lidhur me raportin, pati vërejtje sepse nuk është i shkruar në gjuhën boshnjake dhe pyeti: Pse ka ndodhur kjo, a është për arsye financiare apo lëshim? Meqë RTK-ja po e financon vetëm për gjuhën serbe programin e dytë dhe kjo bëhet për arsye financiare.

**Kurtan Kajtazi** – Sa i përket raportit, kërkoj të dijë se në krahasim me vitin paraprak a ka përmirësime në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, pastaj shtroi pyetjen: Si është gjendja tani në vitin 2012?

Ai gjatë diskutimit të tij e përshkroi gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut shumë më të mirë, më të avancuar se në vitet paraprake, e sidomos në fushën e barazisë gjinore. Gjatë monitorimit të ligjeve që është duke bërë Komisioni, në Ligjin për barazi gjinore të dhënat tregojnë se gjendja në institucionet publike nuk është e keqe, prandaj pyes IAP-in: Pse këto nuk përmenden në raport, por i lihet një përshtypje qytetarit se gjithçka është e zezë në këtë drejtim?

**Sami Kurteshi, Avokat i Popullit** – Në vija të trasha i ofroi përgjigje deputetit në fjalë dhe nuk pati vërejtje rreth përgjigjes së ofruar.

**Albana Gashi** – Kërkoj sqarim rreth kapitullit të lirisë së tubimit dhe tha se ju keni dhënë mendimin e Inspektoratit Policor rreth protestës së mbajtur më 12 maj, kinse policia ka kryer detyrën në përputhje me ligjin dhe nuk ka pasur shkelje të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë rast, ju keni dhënë vetëm mendimin e policisë, por më vonë është thënë se është dënuar polici i cili ka shkaktuar dhunë, kështu që nuk janë këto në përputhje çka ka thënë Inspektorati Policor, ndërsa atë që ka vendosur gjykata më vonë, ju nuk e keni dhënë mendimin e juaj, por të Inspektoratit Policor.

Po ashtu, ajo tha se kam një vërejtje, ku në raport thuhet se viteve të kaluara ka ndodhur përdhosja e varrezave, këtu është raporti i vitit 2011 dhe duhet të bëhet fjalë vetëm për atë vit, sepse ky është Raport vjetor, e jo për vitet e tjera të kaluara. Gjithashtu, tha se keni thënë se nuk ka siguri në fshatrat ku banon komuniteti kroat, ndërsa nuk e keni cekur se nga kush kërcënohet ai komunitet.

Ajo shtroi pyetje edhe rreth votimit të mërgimtarëve dhe tha se ata kanë pasur vështirësi gjatë votimit. Sipas saj, votimi nuk ka shkuar në gjendje të rregullt. Pyeti: A keni vërejtje ju si institucion dhe a keni dalë me rekomandim për këtë ?

**Sami Kurteshi** – Lidhur me pyetjen e shtruar nga deputetja, theksoi se ka mundësi që ne kemi marrë atë se çka është konstatuar nga Inspektorati Policor, por kur shkon rasti në gjykatë, lënda është e papërfunduar, nuk e kemi rezultatin se çka ka vendosur më vonë gjykata, sepse mund të ndodhë që lënda është e vitit 2011, ndërsa gjykata të vendosë në vitin 2012, dhe nuk kemi rezultatin, sepse raporti është i vitit 2011. Sa i përket asaj se ne e kemi dhënë mendimin ashtu si ka thënë Inspektorati Policor, ne kemi kërkuar mendimin e tyre, sepse ne i kemi mbledhur faktet dhe ia kemi dërguar policisë për shqyrtim. Ne duhet t'i shterim mjetet ligjore, sepse kjo është puna jonë dhe nuk mund të dalim jashtë kompetencave tona.

Ai tha se sa i përket pasaktësisë së viteve në varrezat e komunitetit ortodoks, është vërejtje e saktë, por me siguri është bërë ndonjë lëshim gjatë hartimit të raportit.

Sa i përket sigurisë së komunitetit kroat, ata janë njerëz të vjetër që jetojnë vetë. Fëmijët nuk i kanë këtu dhe një krismë të vogël e perceptojnë si rrezik për ta. Ata nuk kanë pasur ndonjë sulm konkret dhe nuk e kemi thënë ashtu.

Sa i përket votimit jashtë vendit, ne nuk kemi pasur asnjë rast të ankesave nga jashtë. Ne kemi të drejtë që t'i shqyrtojmë ankesat nga jashtë, të cilat bëhen në adresë të institucioneve të vendit tonë, por nuk kemi pasur ankesa të tilla sa i përket votimit.

**Kimete Bytyçi** – Në raport thuhet se ka mosharmonizim në mes të Ligjit të punës dhe Ligjit për shërbyesit civilë. Çka është ndërmarrë në harmonizimin e tyre, sa ka marrë nisma legjislative Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi që Ligji për Avokatin e Popullit ua mundëson një gjë të tillë?

**Sami Kurteshi, Avokat i Popullit** – Personi që ka punuar në këtë temë nuk është prezent këtu. Ka mospërputhje sa i përket stazhit, ditëve të punës gjatë vikendit dhe kompensimit.

**Suazan Novoberdali, Kimete Bajraktari dhe Isa Hasani** diskutuan lidhur me raportin. Diskutimet e tyre u mirëpritën nga anëtarët e Komisionit. Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv lidhur me shqyrtimin e Raportit të punës së IAP për vitin 2011, Komisioni nxori unanimisht këtë

#### Rekomandim

1. Të miratohet Raporti vjetor i punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011.

2. Komisioni i rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, që t'i mundësojë Avokatit të Popullit që ta paraqesë në Kuvend Raportin vjetor të punës për vitin 2011, si dhe t'i mundësojë që pyetjeve të deputetëve për të cilat ai konsideron se duhet të japë sqarime, t'u përgjigjet duke ndarë një kohë të caktuar në fund të debatit.

3. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.  
E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

---

Suzan Novoberdali